

11 Maj, 2016

Komunikatë për media

Prezantimi i projektit “Koalicioni të drejtat e barabarta për të gjithë”

Sot, u organizua një konferencë në Prishtinë/Priština për të prezantuar krijimin e **Koalicionit** të ri dhe projektin katër (4) vjeçarë "**Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë (ERAC)**". Konferenca u hap nga **Z. Christof Stock**, Shef i Operacioneve, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, i cili theksoi rëndësinë e shoqërisë civile në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, implementimit të kornizës ligjore të Kosovës, si dhe bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe institucionet qeveritare. Z. Stock tha se krijimi i ERAC dhe projekti është iniciativë e rëndësishme e cila bashkon **shtatë (7) OJQ-të** të mesme dhe **nëntëmbëdhjetë (19) OJQ** në nivel lokal, që punojnë në fushën e **sundimit të ligjit** dhe **të drejtave themelore** dhe punojnë në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtat themelore të grupeve të rrezikuara dhe/ose të marginalizuara (GRM-ve) të cilët janë: **komunitetet jo-shumicë, gratë, rinia**, dhe **komuniteti LGBT**.

Përveç kësaj, përfaqësuesit e ERAC prezantuan qëllimin e krijimit të koalicionit, cilët janë anëtarët e Koalicionit dhe aktivitetet që do të zbatohen në një periudhë katër (4) vjeçare. Për më tepër, **Z. Nenad Rašić**, përfaqësues i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Personat e Zhdukur dhe Peticion, **Z. Hilmi Jashari**, Avokati i Popullit i Kosovës, si dhe **Znj. Sadete Demaj-Kajtazi** Koordinatore në Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministri folën edhe për institucionet që përfaqësojnë dhe gatishmërinë e tyre për të mbështetur ERAC në arritjen e qëllimit të përgjithshëm të projektit.

Qëllimi dhe Objektivat e ERAC

- ❖ Krijimi i një rrjeti bashkëpunues të OJQ-ve me bazë në terren dhe atyre të mesme që ofrojnë ndihmë efikase dhe mbështetje për pjesëtarët e GRM-ve që përballen me qasje të kufizuar në të drejtat themelore të njeriut;
- ❖ Vendorsja një pjesëmarrje kuptimplote dhe të informuar, në procesin e vendimmarrjes dhe të krijimit të politikave të qeverisë, për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të GRM-ve në bazë të hulumtimit të politikave shumë disiplinore dhe sektoriale;
- ❖ Forcimi i (a) kapaciteteve institucionale dhe (b) aftësive ndërdisiplinore;
- ❖ Ngritja e vetëdijes së përgjithshme mbi rolin e shoqërisë civile në demokracinë pjesëmarrëse dhe në veçanti në lidhje me të drejtat themelore për të gjithë.

